



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media

Mbledhja nr. 34

Prishtinë, më 24 shtator 2018, në orën:10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-204

Procesverbal

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Shqipe Pantina, Jasmina Zhivković, Valon Ramadani, Adem Mikullovi, Imet Rrahmani, Arban Abrashi, Xhevahire Izmaqi, Rasim Selmanaj, Milaim Zeka dhe Albert Kinolli.

Në mbledhje morën pjesë përfaqësuesit e Zyrës së BE-së, OSBE, KDI-së, INPO, D+, RTV21, BIRN dhe Informatat.com, RTK.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Drita Morina dhe Mirjeta Heta.

Mbledhjen e kryesoi: Nait Hasani, kryetar i komisionit.

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i raporteve të komisioneve të përhershme për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-036 për Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës;
3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.06/L-097, për Transmetuesin Publik të Kosovës;
4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 06/L-111, për Pagat në Sektorin Publik;
5. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 06/L-113, për Organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura;
6. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.06/L-114, për Zyrtarët Publik;
7. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-081, për Qasje në Dokumentet Publike;
8. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-092, për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Me kërkesën e anëtarëve të komisionit se ishte i ngarkuar rendi i ditës u miratua me këtë ndryshim, duke i tërhequr pikat: tre, katër, pesë, gjashtë dhe shtatë.

2. Shqyrtimi i raporteve të komisioneve të përhershme për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-036 për Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës

Komisioni ka shqyrtuar raportet me rekomandime të komisioneve kryesore dhe ka konstatuar se nuk ka vërejtje në raportin me rekomandime të Komisionit Funkcional dhe unanimisht përkrahu raportin me rekomandime për miratim në seancë plenare.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-092, për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës

Nait Hasani, propozoi që p/ligji në fjalë të shqyrtohet pas takimit me Asociacionin e Komunave dhe kryetarët e komunave që do të mbahet më 26 shtator 2018 dhe pas takimit në të cilin do të prezantohen, vërejtjet dhe propozimet për p/ligjin, Komisioni të shqyrtojë dhe të hartojë propozim-ndryshimet në P/ligjin për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

Komisioni unanimisht përkrahu propozimin e kryetarit të Komisionit.

4. Të ndryshme

Milaim Zeka, lidhur me vendimin e KPM-së për shqiptimin e masës së përkohshme ndaj ART-Motion, për nxjerrjen e të cilit vendim kanë marrë për bazë kërkesën e Komisionit Funkcional, se gjoja komisioni ka kërkuar shqiptimin e masës së përkohshme ndaj ART-Motion, tha se nuk ka informacion se komisioni ka kërkuar një masë të tillë, përveç që komisioni parlamentar ka kërkuar ndërmarrjen e masave ndaj UEFA-s. Nxjerrja e një vendimi nga KPM-ja është shkelje ligjore, për çka u deklarua se do të kërkojë shkarkimin e anëtarëve të KPM-së.

Nait Hasani, e njoftoi komisionin për një takim joformal që do të mbahet me përfaqësues të Zyrës së BE-së në Kosovë, për P/ligjin për pagat, P/ligjin organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe agjencive të pavarura dhe P/ligjit për zyrtarët publikë, i cili takim do të mbahet më 27 shtator 2018.

Mbledhja përfundoi në orën:11:10.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetari i komisionit,

Nait Hasani